



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2023:080562

Datë: 28.07.2023

Numri i dokumentit: 04533923

PML.nr.374/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Agim Maliqi, kryetar i kolegjit, Rasim Rasimi dhe Valdete Daka, anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Qefsere Berisha, në çështjen penale ndaj të pandehurit V. S., për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer dy vepra penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par. 2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK, duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të pandehurit avokatit Haxhi Sinanaj, paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Pejë - Departamenti për Krime të Rënda DKR.PP.nr.34/2023 të datës 23 qershor 2023 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PN1. DKR.nr.709/2023 të datës 10 korrik 2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 28 korrik 2023, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Me miratimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të të pandehurit V. S., ndryshohen aktvendimi i Gjykatës Themelore në Pejë - Departamenti për Krime të Rënda DKR.PP.nr.34/2023 të datës 23 qershor 2023 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PN1.DKR.nr.709/2023 të datës 10 korrik 2023, ashtu që të pandehurit i ndërpritet masa e paraburgimit dhe i njëjti lirohet menjëherë për t'u mbrojtur në liri.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Pejë – Departamenti për Krime të Rënda, me aktvendimin DKR.PP.nr.34/2023 e datës 23 qershor 2023, të pandehurit V. S., për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer dy vepra penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par. 2 të KPRK, ia ka vazhduar masën e paraburgimit edhe për 2 (dy) muaj e cila sipas këtij aktvendimi do t'i zgjasë nga data 28 qershor 2023 e deri me datën 27 gusht 2023, konform nenit 184 par.1 dhe 2 pika 1.2.2 dhe 1.2.3 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK).

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktvendimin PN1. DKR.nr.709/2023 të datës 10 korrik 2023, e ka refuzuar ankesën e mbrojtësit të të pandehurit V. S. si të pabazuar dhe e ka vërtetuar aktvendimin e shkallës së parë.

Kundër këtyre aktvendimeve kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka ushtruar mbrojtësi i të pandehurit V. S. avokati Haxhi Sinanaj, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, me propozim që aktvendimet e kundërshtuara të ndryshohen dhe i pandehuri të lirohet për mbrojtur në liri.

Kryeprokurori i Shtetit Kosovës, me parashtresën KMLP.III.nr.155/2023 e datës 27 korrik 2023, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit, shqyrtoi shkresat e kësaj çështjeje juridiko-penale dhe pas vlerësimit të pretendimeve gjeti se:

- kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar.

Në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, mbrojtësi i të pandehurit thekson se gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë, në arsyetim nuk kanë dhënë arsyetim konkret për vazhdimin e masës së paraburgimit. nuk ekziston mundësia e ndikimit në dëshmitarë të pidentifikuar si dhe mundësia e ndikimit në ekspertizat e ekzaminimit balistik të armës, si dhe në raportin e ekzaminimit të substancave të dyshuara narkotike. Po ashtu edhe konstatimi se është recidivist i veprave penale nuk është i bazuar sepse i pandehuri më parë nuk është dënuar për këto vepra penale.

Sipas vlerësimit të kolegjit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimet nga kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë janë të bazuara, sepse në vendimet e kundërshtuara nuk qëndrojnë bazat ligjore për të cilat gjykatat e instancave më të ulëta e kanë vazhduar masën e paraburgimit ndaj të pandehurit.

Kjo Gjykatë konsideron se nuk qëndron baza ligjore e parashikuar me nenin 184 par. 1 nën par. 1.1 e 1.2 pika 1.2.2 të KPP, ngase i pandehuri nuk ka mundësi të ndikojë në dëshmitarë abstrakt e të pidentifikuar, po ashtu nuk ekziston mundësia e ndikimit në raportet e ekzaminimeve balistike dhe të mjeteve të dyshuara narkotike ngase ato i zhvillojnë organet kompetente

shtetërore dhe është abstrakt supozimi i ndikimit në to. Po ashtu edhe bazën ligjore nga neni 184 par. 1 nën par. 1.1 e 1.2 pika 1.2.3 të KPP, gjykatat nuk kanë dhënë ndonjë arsye konkrete për mundësinë e përsëritjes së veprave penale për të cilat dyshohet i pandehuri, recidivizmi mund t'i merret si rrethanë rënduese në fazat e mëvonshme të procedurës penale, me rastin e matjes së dënimit, nëse shpallet fajtorë, mirëpo nuk mund të jetë bazë për vazhdimin e pafund të masë së paraburgimit.

Nga sa u parashtrua dhe në kuptim të nenit 438 par. 1 nën par 1.1 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GYKATA SUPREME E KOSOVËS- PRISHTINË
Pml.nr.374/2023 me datë 28 korrik 2023

Bashkëpunëtorja profesionale,
Qefsere Berisha

Kryetari i kolegjit,
Agim Maliqi